

## MENDIM PAKICE

Unë, anëtarja e trupit gjykues Etleda Çiftja, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, në të cilin shumica ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit: (i) arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe (iii) ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në mbështetje të qëndrimit tim po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues:

### 1. **Deklarimi jo i saktë i burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 112.7 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, Tiranë**

1.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer: (i) shuma prej 5,800,000 lekësh përfituar nga kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 4.9.2009, për shitjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) shuma prej 45,000 euro e marrë hua nga shtetasi A.Ll., sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 23.7.2008; (iii) shuma prej 5,000,000 lekësh e përfituar nga kredia bankare sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 10.2.2011; si dhe (iv) shuma prej 1,980,000 lekësh e përfituar nga ekzekutimi i vendimit nr.\*\*\*, datë 20.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1.2 Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se<sup>1</sup>: (i) pagesa e kështit të parë në shumën prej 12,000 euro u përmbush në datën 31.7.2009 dhe ka pasur si burim: shumën 6,000 euro të tërhequr nga llogaria bankare e babait; shumën 4,000 USD që u konvertua, në atë kohë, në 2,800 euro, të tërhequra nga llogaria bankare e babait; dhe shumën 3,200 euro nga kështi i parë i shumës 10,000 euro marrë hua nga z. A.Ll., (duke i mbetur në *cash* të papërdorura 6,800 euro).

1.3 Referuar fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ një burim të ri për blerjen e apartamentit, burim të cilin nuk e kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

1.4 **Në konkluzion**, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting “ të vitit 2017 burimin e krijimit të pasurisë së te paluajtshme, apartament.

### 2. **Mbi personin tjetër të lidhur, z. K.S.,**

2.1 Duke qenë se marrëdhënia e qëndrueshme e interesit dhe dhurimeve mes subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur/babait të subjektit, z. K.S., daton që në vitin 2005 dhe përfshin: (1) marrjen nga subjekti të shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD nga llogaria e babait për pagesën e kështit të parë të blerjes së apartamentit nga subjekti; (2) dhurimin e pjesës takuese të vlerës prej 2.900.000 lekësh, nga babai, shumë e përfituar nga shitja e shtëpisë në bashkëpronësi;

---

<sup>1</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti me e-mail-in e datës 20.9.2019.

(3) dhurimet në vlerë monetare, ndër vite, fëmijëve të subjektit; (4) dhënien e shumës prej 700,000 lekësh nga subjekti te babai për pagesën e këstit të blerjes së apartamentit në vitin 2004; (5) shlyerjen e huas të babait marrë shtetasit A.Ll., në vitin 2005; në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 kam vlerësuar se z. K.S., si person tjetër i lidhur, ka detyrimin së bashku me subjektin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të dhuruara/ shkëmbyera me subjektin e rivlerësimit duke filluar nga viti 2005.

### **Mundësia financiare e personit tjetër të lidhur, z. K.S.,**

2.2 Nëse analizojmë mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. K.S., për krijimin e depozitave prej 6,000 euro dhe 4,000 USD, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi nga subjekti për këstin e parë të blerjes së apartamentit në vitin 2009, rezulton se nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e këtyre shumave, për shkak se deri në vitin 2005 ka likuiduar shumën prej 46.000 euro për apartamentin e ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë.

2.3 Nëse analizojmë të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e personit tjetër të lidhur, z. K. S., deri në vitin 2005, konstatohet si vijon:

<b>Analiza financiare periudha 1991 – 31.12.2005</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat <i>neto</i> nga pensioni 1991 – 31.12.2005	1,146,603
Të ardhura të nënës nga pensioni 1993 – 2002	439,359
Të ardhura nga paga e subjektit periudha 1995 – 31.10.2000	1,043,930
Dhurime nga subjekti i rivlerësimit (deklaruar në pyetësor)	700,000
Të ardhura të tjera interesa bono thesari	106,670
Hua nga A. Ll., (deklaruar)	2,140,000
<b>Total të ardhura (1)</b>	<b>5,576,562</b>
Pagesë shpenzime jetese deri ne vitin 2000 për 3 persona (66% <sup>2</sup> e të ardhurave)	2.311.747
Pagesë shpenzime jetese 2001 – 2005, 1 person, INSTAT, ILDKPKI	485,213
<b>Shpenzime total (2)</b>	<b>1,536,007</b>
Blerje apartamenti ref. kontratës, datë 20.10.2004, shuma 51,000 euro	6,430,080
Detyrime 5,000 euro	630,400
<b>Pasuri neto (3)</b>	<b>5,799,680</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2-3)</b>	<b>- 3,020,078</b>

2.4 Referuar analizës më lart, rezulton se personit tjetër i lidhur/z. K.S., ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën – **3,020,078 lekë** deri në vitin 2005, për të paguar këstet e apartamentit, sipas kontratës së porosisë dhe deklarimeve të subjektit.

2.5 Me tej, në lidhje me shumën prej 950.000 lekësh, dhuruar fëmijëve të subjektit respektivisht: për vitin 2008 shumën prej 150,000 lekësh; për vitin 2010 shumën prej 150,000 lekësh; për vitin 2012 shumën prej 200,000 lekësh; për vitin 2013 shumën prej 100 000 lekësh;

<sup>2</sup> Referuar vendimit nr. 18, datë 26.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

për vitin 2014 shumën prej 150 000 lekësh; dhe për vitin 2016 shumën prej 200 000 lekësh, rezulton se personi tjetër i lidhur, z. K.S., ka mungesë të të ardhurave të ligjshme, shoqëruara me dokumentacion justifikues, duke marrë në konsideratë balancën negative të mbartur nga vitet e mëparshme 2005 dhe 2009..

2.6 **Si konkluzion të sa më lart**, unë si anëtare në pakicë, dal në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. K.S., për të blerë pasuri, për të kryer shpenzime, përfshirë dhënien e shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD në vitin 2009, si dhe shumat e dhuruara fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, sipas DPV-ve.

### 3. Mundësia financiare nga të ardhurat e ligjshme të huadhënësit A.Ll.

3.1 Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, personit tjetër i lidhur, z A.Ll., ka këto të ardhura për periudhën 1994 – 2009, si vijon:

- a) Nga aktiviteti si Person Fizik, me objekt “tregti me pakicë artikuj të ndryshëm<sup>3</sup>”, ka qarkullim të deklaruar në shumën prej 11,725,066 lekësh dhe nëse llogarisim të ardhurat *neto* të përfituara nga aktiviteti tregtar i shtetasit A.Ll., në masën 20 % të qarkullimit të deklaruar dhe për të cilin janë paguar detyrimet tatimore përkatëse, të konfirmuara nga organet tatimore qendrore dhe rajonale, rezulton se ky shtetas ka përfituar shumën *neto* prej 2,885,013 lekësh.
- b) Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, të ardhurat nga interesat e përfituara nga shtetasi A.Ll., për periudhën 2002 – 2009, kanë qenë në vlerën prej 978,035 lekësh.
- c) Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja, konstatohet se të ardhurat nga interesat e përfituara nga shtetasi A.Ll., për periudhën 2002 – 2009, kanë qenë në vlerën prej 297,253 lekësh.
- d) Referuar të dhënave nga DPT-ja, ky shtetas ka qenë aksioner në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., me NIPT \*\*\* dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018, DTM-ja informon ILDKPKI-në se kjo shoqëri ka shpërndarë *divident* në vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2008. Sipas shkresës së sipërcituar të DTM-së, *dividenti* i shpërndarë deri në vitin 2008 është në vlerën 175,834,166 lekë. Të ardhurat e përfituara nga z. A.Ll., me burim *dividentin* e shpërndarë nga kjo shoqëri, përllogariten në shumën prej 29,892 lekësh. Gjithashtu, nga QKB-ja<sup>4</sup> konfirmohet se shtetasi A.Ll., në datën 2.6.2008,<sup>5</sup> ka shitur 45 aksione që zotëronte në këtë shoqëri, në vlerën 45,000 lekë.

<sup>3</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2019.

<sup>4</sup>E-mail-i i datës 13.8.2018, administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar të kësaj shoqërie nga faqja zyrtare e QKB-së.

<sup>5</sup>Kontratë nr. \*\*\* , datë 2.6.2008.

- e) Referuar të dhënave të dërguara nga DRT-ja Tiranë<sup>6</sup>, bazuar në përqindjen e aksioneve që shtetasi A.Ll., zotëronte në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., duket se ka përfituar të ardhura nga shpërndarja e *dividentit* në vlerën prej 9,352 lekësh.
- f) Referuar të dhënave të dërguara nga ISSH-ja<sup>7</sup>, të ardhurat nga paga të përfituara nga z. A. Ll., për periudhën 2005 – 2009, janë në total në vlerën prej 806,724 lekësh. Totali i këtyre të ardhurave është në shumën 5.051.269 lekë.

3.2 Shpenzime jetike për person/z. A.Ll., janë në shumën 1,099,098 lekë sipas INSTAT/ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2009, por pa llogaritur shpenzime jetike për periudhën 1994 – 2000, sikundër janë përfshirë të ardhurat. Duke konsideruar këtu edhe huan në vlerën prej 6,208,200 lekësh (45,000 euro), në vitin 2009 rezulton se personi tjetër i lidhur ka pasur balancë negative të fondeve për vlerën 2,256,029 lekë.

3.3 Në lidhje me përfshirjen në analizë financiare, të ardhurat e z. I.Ll., (babai i z. A. Ll.), unë si anëtar në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se personi tjetër i lidhur/z. A.Ll., nuk provoi me dokumentacion ligjor provues të drejtat e administrimit të të ardhurave dhe pasurive të babait të tij dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme të huadhënësit.

3.4 Gjithashtu, nuk u paraqit as edhe një provë nga subjekti i rivlerësimit për të provuar kalimin e këtyre shumave të përfituara nga shitja e pasurive apo të tjera nga z. I.Ll., te huadhënësi A. Ll., në mënyrë që ky i fundit të kishte mundësi t’i jepte hua subjektit të rivlerësimit. Deklaratat noteriale të bëra gjatë hetimit edhe ato pas rezultateve të hetimit nga huadhënësi dhe familjarët e tij, ngelen vetëm në nivel deklarativ dhe nuk mund të marrin vlerë provuese.

3.5 **Si konkluzion të sa më lart**, unë si anëtare në pakicë, dal në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/ huadhënësit/z. A.Ll., për shumën e dhënë hua prej 45.000 euro.

**Në përfundim**, në lidhje me analizimin e burimeve të blerjes së këtij apartamenti me sip. 112.7 m<sup>2</sup> në Tiranë, unë si anëtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, dal në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për këtë qëllim;
- ii. ka paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri; dhe
- iii. ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### **4. Mbi të ardhurat e ligjshme të dhuruesit I.T.**

4.1 Nga hetimi administrativ dhe deklaramet e subjektit, ndër vite, ka rezultuar se z. I.T., respektivisht babai i bashkëshortit të subjektit i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit: (1) në vitin 2011 – shumën prej 10.000 euro për blerje garazhi tek apartamenti i ndodhur në “\*\*\*\*” Tiranë;

---

<sup>6</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot.

<sup>7</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2019.

(2) në vitin 2014 – shumë prej 8,000 euro për mobilimin e apartamentit Rr. “\*\*\*\*”, Vlorë; dhe (3) dhurata për fëmijët e subjektit, ndër vite (për vitin 2010 – shumë 2,000 euro, për vitin 2013 – shumë 200,000 lekë, për vitin 2015 – shumë 120,000 lekë, si dhe për vitin 2016 – shumë 250,000 lekë).

4.2 Pavarësisht konkluzionit të shumicës se personi tjetër i lidhur ka pasur mundësi nga burime të ligjshme për dhurimet e bëra, në analizë duhet të ishin marrë edhe blerja e automjetit tip “Mercedes Benz”, në vitin 2013, përdorur nga subjekti dhe bashkëshorti, si edhe apartamenti me sip. 74 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2002, ndodhur në fshatin \*\*\*\*, Golem, Kavajë (apartamenti i cili përdoret nga subjekti i rivlerësimit për pushimet verore).

4.3 Unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se elementi thelbësor për një analizë të drejtë të mundësive të personit tjetër të lidhur, është koha se kur këto dhurime janë dhënë dhe aftësia financiare e dhuruesit në vitin respektiv. Analiza financiare për personin tjetër të lidhur/z. I. T., duhet të ishte kryer nga shumica e trupit gjykues, bazuar në vitin përkatës kur dhe janë deklaruar se janë bërë këto dhurime dhe jo në përgjithësi.

4.4 Nëse do t’i referohemi provave të administruara nga hetimi, por dhe atyre të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe analizës së kryer, unë, si anëtare në pakicë, nuk krijoj arrij në përfundimin se personi tjetër i lidhur/z. I.T., nuk ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dhuruar këto shuma të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe DPV-të vjetore, për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e domosdoshme për të dhe familjen e tij.

4.5 Në këto kushte, unë, si anëtare në pakicë, dal në konkluzionin se në gjendjen që janë provat subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur/z. I.T., nuk provuan bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme për të blerë pasuritë, kryer shpenzimet dhe të bëjë dhurimet e përshkruara më lart.

## **5. Mbi mosdeklarimin në deklaratën “Vetting” dhe ndër vite, të burimeve të krijimit të likuiditeteve në bankë (depozita apo llogari rrjedhëse)**

5.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar likuiditetet në bankë<sup>8</sup> dhe për asnjë nga këto likuiditete (llogari bankare) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre, referuar pikës 1, të Aneksit D, të Kushtetutës, si dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>8</sup>Gjendje depozitë në euro<sup>8</sup>, llogari në BKT-së, në emër të subjektit të rivlerësimit, shuma prej 1,105.18 euro; gjendje depozitë në lekë, në llogari në BKT, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së saj E.Toro, në vlerën 2,536,585.17 lekë; gjendje depozitë në lekë, në llogari në BKT, në emër të E.T., dhe Elona Toro, në vlerën 1,354,506.99 lekë; gjendje në llogarinë e pagës në lekë në “Credins Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 216,069.08 lekë; gjendje llogarie në lekë në BKT (llogari e kredisë) në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 144,004.36 lekë; gjendje llogarie në euro, në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A.T., (person fizik), në vlerën 2,324.38 euro; gjendje llogarie në lekë, në BKT, në emër të bashkëshortit, z. A. T., (person fizik), në vlerën 684,369.8 lekë; gjendje llogarie në lekë në BKT, në emër të bashkëshortit, z. A.T., në vlerën 114,761.24 lekë; gjendje llogarie në euro, në bankën “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në vlerën 2,768.81 euro; gjendje llogarie në lekë, në “Union Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A.T., në vlerën 208,637 lekë; gjendje llogarie në lekë, në BKT, në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 174,489.98 lekë; gjendje llogarie në lekë në BKT (llogari kursimi), në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1,501.94 lekë.

5.2 Gjithashtu, edhe po t'i referohemi deklarimeve periodike vjetore, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa dhe pakësime në deklarime sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për kontrollin dhe deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

5.3 Në konkluzion, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë llogaritë bankare në pronësi gjatë viteve dhe në deklaratën veting 2017, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me likuiditetet në bankë, si dhe nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë të kundërtën e barrës së provës.

## **RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

1. Bazuar në përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit, bazohet në aftësinë për të gjykuar aftësinë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.

2. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, pika 1, e nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për at sa ky ligj gjen zbatim.

3. Referuar burimeve dhe procedurës së përcaktuar nga ky kuadër ligjor, duke përfshirë në këtë vlerësim edhe denoncimin e fakteve nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime.

4. Për sa më sipër, bazuar në raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe në aktet e administruara për këtë qëllim, çështjet për të cilat subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime, ndër të tjera, janë si më poshtë:

❖ *Në lidhje me të dhënat nga burimet arkivore të ish- KLD-së, pjesë të raportit të vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale*

5. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016”, për gjyqtaren Elona Toro janë paraqitur gjithsej 9 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (3 në vitin 2013, 2 ankesa në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016), nga të cilat: (a) 4 ankesa (1 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, një ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë dhe tri me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor; (b) 5 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë, si më poshtë:

5.1 Për vitin 2013 – një ankesë e verifikuar për zvarritje i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; një ankesë e verifikuar për zvarritje dhe njëanshmëri gjykimi nga të cilat pretendimi për njëanshmëri është arkivuar si i pabazuar, ndërsa për zvarritje i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik, për tejkalim të afatit standard të gjykimit, pasi referuar kompleksitetit të çështjes dhe numrit të palëve ndërgjyqëse, shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë të justifikuara; një ankesë e vitit 2013 verifikuar për zvarritje dhe shkelje formale ligji, gjyqtares i është tërhequr vëmendja me shkrim për tejkalim të afatit standard të gjykimit për shkak të mosmenaxhimit të mirë të gjykimit.

5.2 Për vitin 2014 – verifikuar për zvarritje gjyqtares i është tërhequr vëmendja me shkrim për tejkalim të afatit procedural për gjykimin e një kërkesë me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”.

5.3 Për vitin 2015 – një çështje i është verifikuar për shkelje formale ligji, dhe i është regjistruar **gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.**

6. Referuar të dhënave të administruara nga KLGJ-ja në lidhje me ankesat dhe masat e marra, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se verifikimet e kryera nga institucioni përgjegjës, duke përfshirë tërheqjen e vëmendjes dhe shkeljet e tjera të konstatuara për efekt të vlerësimit profesional dhe etik, duhet të vlerësohen sipas neneve 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. **Në përfundim**, nga shqyrtimi i këtyre ankesave dhe vlerësimi i tyre, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të përballuar ngarkesën në punë dhe aftësinë për të administruar dosjet gjyqësore.

❖ ***Të dhëna mbi mangësi procedurale nga dosjet e përzgjedhura me short, pjesë e raportit të KLGJ-së***

8. Vlerësim, i cili mbështetet edhe në të dhëna të tjera, të evidentuara në raportin i vlerësimit të përgatitur nga KLGJ-ja, ku u konstatuan gjithashtu se subjekti i rivlerësimit :

8.1 Në dosjen 3 – është vërejtur se ndërsa në pjesën arsyetuese të vendimit konkludohet për një masë konkrete dëmshpërblimi, vlera nuk reflektohet në dispozitivin e vendimit, si dhe vendimi është prishur dhe kthyer për rigjykim për mungesë hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, për mosdisponimin në dispozitiv të vlerës konkrete të dëmshpërblimit.

8.2 Në dosjen 4 – nuk është arsyetuar rreth shkaqeve për caktimin e masës së dëmshpërblimit nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës, ndërsa është arsyetuar në detaje mbi vlerësimin se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të pajustificuar, në shkelje të procedurës dhe të afatit të njoftimit.

8.3 Në dosjet 1, 2 dhe 3 – është tejkaluar afati standard i gjykimit i vendosur nga KLD-ja.

8.4 Në dosjet 4 – nga 5 raste mungon vendimi për caktimin e seancës përgatitore, referuar dosjeve 1,2, 3 dhe 4 dhe në 1 rast mungon vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, në dosjen 5.

8.5 Në rastin e dosjes 5 – mungon gjithashtu, akti për caktimin e gjyqtares për gjykimin e çështjes, si dhe akti i njoftimit të palëve.

8.6 Në një rast është vërejtur mungesë e procesverbalit gjyqësor të datës 20.11.2014.

❖ ***Të dhëna mbi aftësitë organizative të subjektit të rivlerësimit të evidentuara nga denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016***

9. Denoncim<sup>9</sup> i shtetasit H.Sh., administruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2018 , i cili ankohet për zvarritje gjykimi në procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse, paditës H.Sh., i paditur Komuna Petrelë, me objekt “lirim dhe dorëzim sendi, shpërblim dëmi etj.”

Denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Duket se, kryesisht, ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë.

Gjithashtu, denoncuesi referon se gjyqtarja Elena Toro, për këtë çështje të gjykuar prej saj – ka marrë vërejtje nga KLD-ja për zvarritje të procesit. Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosje konstatohet se denoncuesi, z. H.Sh., ka depozituar në KLD ankesë ndaj gjyqtares Elona Toro (Stavri) (ankesë nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2013), për çështjen e gjykuar nga kjo gjyqtare në të cilën ka qenë palë – dhe për të cilën gjyqtarja ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2009.

10. Denoncim<sup>10</sup> i shtetasit A.Sh.; denoncim<sup>11</sup> i shtetasit B.M.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri), për vendimmarrje të padrejtë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Denoncuesi hedh dyshime për kryerjen e veprimeve korruptive prej trupës gjyqësore, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri). Gjithashtu, denoncuesi pretendon se kjo trupë gjykuese ka kryer shkelje të rëndë ligjore, pasi ka dhënë vendim, pa pritur që prokuroria të shprehej me vendim përfundimtar – për të cilin lidhur me objektin e gjykimit civil kishte bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijim denoncohet se kjo gjyqtare ka gjykuar edhe më parë çështje që kanë të bëjnë me pjesë pasurie, të cilat janë objekt i këtij gjykimi. Denoncuesi referon se të dyja vendimet janë prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, ku ndër të tjera, bashkëlidhur ka dërguar vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhënë nga gjyqtarja Elona Toro), si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (marrë nga trupi gjykues në përbërje të të cilit në cilësinë e anëtares është edhe gjyqtarja Elona Toro).

11. Denoncim<sup>12</sup> i shtetasit K.J.

Denoncuesi ankohet për shkelje ligjore në vendimin me nr. \*\*\*, datë 6.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti Elona Toro (Stavri) denoncohet për zvarritje të procesit gjyqësor, duke simuluar për 26 muaj mosekzekutimin e titullit të ekzekutimit të qershorit 2005 – se ka kryer 18 seanca të panevojshme, nga të cilat 7-8 seanca të shtyra për mosformim të trupit gjykues.

Sipas denoncuesit, megjithëse gjykata e pushoi gjykimin la në fuqi masën e pezullimit. Denoncuesi pretendon se prej vonesave të krijuara në proceset e tjera gjyqësore, vendimeve të ndërmjetme të

<sup>9</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2018.

<sup>10</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2018.

<sup>11</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.8.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018.

<sup>12</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2018.

gjykatave, si edhe vendimmarrjes së gjyqtares Elona Toro, e cila la në fuqi masën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe lirim të sendit për disa vjet – kjo masë u shua juridikisht, megjithëse pala kundërshtarë i humbi të gjitha gjyqet. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit, fotokopje të faqes së parë të vendimit të sipërcituar, si dhe fotokopje të faqes së parë të dosjes gjyqësore.

12. Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij të barrës së provës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit mbi denoncimet nga publiku, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm arsyet e zvarritjeve të këtyre çështjeve, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, shkeljet ligjore të kryera, etj., referuar barrës së provës për denoncimet nga publiku, të sipërcituara dhe të dhënave prej KLGJ-së.

13. Nisur edhe nga orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku në vendimin (JR) nr. 21/2019, paragrafi 26, pika 26.1.1, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, ndër të tjera, përcakton se: “[...]. Gjithashtu, trupi gjyqësor i Kolegjit konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 [...]”

**Në konkluzion** të rivlerësimit të aftësive profesionale, referuar të dhënave nga burimet arkivore dhe raportit të KLGJ-së mbi vlerësimin e aftësive profesional, denoncimeve nga publiku, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, unë çmoj se subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për rivlerësimin e aftësive profesionale.

### **Konkluzion përfundimtar**

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të ndërthurura edhe me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka një mënyrë pune e cila nuk pajtohet me pozicionin e saj dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi zvarritjet e përsëritura të gjykimit dhe të disa shkeljeve ligjore.

**Si përfundim**, në vlerësimin përfundimtar në lidhje me kriterin vlerësimit të pasurisë dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, unë, si anëtare në pakicë, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit klasifikohet në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë. Mangësitë profesionale të vlerësuara më lart, së bashku me deklarimin e pamjaftueshëm

për vlerësimin e pasurisë , në vlerësimin tërësor plotësojnë kuadrin ligjor për të disponuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit duhet të ishte shkarkuar nga detyra nga shumica e trupit gjykues.

**Etleda ÇIFTJA**

**Anëtar/kundër**